



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:273159

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05585353

P.nr.330/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, me procesmbajtësen Hale Ahmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurit F.E, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1992/2022 të datës 09.12.2022, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar më datë **28.02.2024**, në praninë e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, të dëmtuarit Q.B dhe të pandehurit F.E se bashku me mbrojtësin e tij av. Valon Demiraj nga Istogu, të caktuar sipas detyrës zyrtare, të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me datë 22.03.2024, përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

F.E, nga i ati S dhe e ëma Sh. e gjinisë G., i lindur me datë ... në Istog, tani me vendbanim në fshatin S. Komuna Istog, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, me gjendje të dobët ekonomike, me numër personal: 1242157024, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 21.09.2021, rreth orës 20:30 min, në aksin rrugor G.-P., pikërisht në fshatin B., Komuna I., shkel Ligjin mbi Trafikun Rrugor dhe me këtë i shkakton lëndim të rëndë trupor këtu të dëmtuarit Q.B, në atë mënyrë që ditën kritike deri sa i pandehuri F.E, ishte duke drejtuar automjetin e tij A) VW Golf, me ngjyrë të hirit, me targa 03/584-EI, dhe ishte duke qarkulluar në aksin rrugor Gurrakoc-Pejë dhe me të arritur në fshatin B., rruga që të shpie në fshatin K., kthehet majtas duke mos u siguruar se atë veprim mund ta kryej sigurte dhe pa i penguar pjesëmarrësit tjerë në trafik dhe gjatë kthimit majtas i pandehuri F. ia ndërpre në rrugën shiritit qarkullues drejtuesit të B) motoçikletës së Q.B, i cili qarkullonte në drejtimin P-G, ku për shkak të distancës se shkurtër nuk kishte arritur të ndalet dhe me pjesën e parë të anës së djathtë e godet automjetin VW Golf në pjesën e djathtë mbrapa, me ç'rast shkaktohen dëme materiale si

dhe pëson lëndime të renda trupore i dëmtuari Q.B ndërsa i dëmtuari Sadik Brahimaj i cili ishte pasagjer në motoçikletë pëson lëndime të lehta trupore sipas Akt-ekspertimit mjeko ligjor të datës 14.06.2022.

- me çka ka kryer veprën penale **rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së.**

Gjykata duke u bazuar në nenin e lartcekur të veprës penale dhe dispozitat e nenit 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42,46, 47, 48, 49, 69, 71, 72, 79 të KPRK-së dhe nenin 242, 364, 369 dhe 462 të Kodit të Procedurës Penale (tutje KPP-së), të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

- I.** Ashtu që, të pandehurit **F.E**, i shqiptohet dënimi më burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, *i cili dënim do të jetë i kushtëzuar, nuk do të ekzekutohet* nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.
 - **Në të kundërtën**, nëse i pandehuri brenda periudhës së lartcekur të verifikimit kryen vepër tjetër penale, atëherë gjykata në bazë të nenit 50 të KPRK-së, do t'a revokon dënimin me kusht dhe ndaj personit të dënuar do të ekzekutohet dënimi me burgim, ashtu që, do të shqiptohet dënimi për veprën penale të kryer më parë dhe veprën penale të re.
- II.** Të pandehurit **F.E**, i shqipton edhe **dënim plotësueses, ndalimi i drejtimit të automjetit**, ashtu që: pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të pandehurit i ndalohet drejtimi i automjetit për kategoritë "B", në kohëzgjatje prej një (1) viti. **Këtë dënim plotësues duhet t'a ekzekutoj Policia e Kosovës – Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor (NjRKRR) në Pejë.**
- III. OBLIGOHET** i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, të paguajnë për ekspertizën mjeko-ligjore shumë prej **njëzet (20) euro**, për ekspertizën e komunikacionit shumë prej **dyzet (40) euro**, paushallin gjyqësor në shumë prej **njëzet (20) euro**, ndërsa në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej **njëzet (20) euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV. Pala e dëmtuar:** Q.B dhe S.B qe te dy nga fshati Rakosh, Komuna Istog, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen ne kontest te rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës penale

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1992/2022 të datës 09.12.2022, kundër të pandehurit F.E, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 28.02.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, i dëmtuari Q.B dhe i pandehuri F.E se bashku me mbrojtësin e tij av. Valon Demiraj, te caktuar sipas detyrës zyrtare, ku pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjykata pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, dhe pas njoftimit me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, i ka mundësuar të pandehurit të deklarohet për pranimin e fajësisë apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri F.E, pas konsultimit me mbrojtësin e tij, ka deklaruar: se e pranon fajësinë për veprën penale për te cilën akuzohet, është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e bëj në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, duke shtuar se i premtonte gjykatës se në të ardhmen do të këtë sjellje të shtuar në komunikacion dhe nuk do të kryej vepra tjera penale.

Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar: se pajtohem me pranimin e fajësisë të deklaruar nga ana e të pandehurit për veprën penale për te cilën akuzohet, një pranimi tillë u bë në mënyrë vullnetare dhe gjënë mbështetje të plote edhe me provat që gjenden në shkresë të lëndës.

I dëmtuari Q.B, lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar: së nuk e kundërshton pranimin e fajësisë dhe nuk ka diçka tjetër për të deklaruar.

Mbrojtësi i të pandehurit F.E, av. Valon Demiraj, lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar: se e mbështesë pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim, një pranim i tillë vije si rezultat i konsultimit me të njëjtin ashtu që pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme meqenëse i njëjti e ndjenë veten fajtorë për veprën penale që i bije në barrë, i propozoj gjykatës që me rastin e vendosjes lidhur me vendimin mbi dënim, dënimin eventual të shqiptuar me burgim të ia rikthej në atë të kushtëzuar sepse i njëjti është në gjendje të dobët ekonomike, bujk dhe mbajtës i familjes.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata në rastin konkret lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pas marrjes së mendimeve të lartcekura, si dhe se pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 242 par. 1, par. 2 nën par. 2.1, 2.2 dhe 2.3, dhe par.3 të KPP-së, përkatësisht pas vlerësimit se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 242 par. 2, nën par. 2.4 të KPP-së, gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri për veprën penale të lartcekur për te cilën është akuzuar.

Vendimi për shpalljen fajtor

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të pandehurin t'a shpall fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, po ashtu në veprimet e tij manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale të lartcekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe konstatimit nga gjykata të përmbushjes së kushteve në referim të nenit 242 par. 1, 2 dhe 3 të KPP-së, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Rrethanat që janë marre për bazë me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si **rrethana lehtësuese** ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, nuk ka qenë i dënuar me parë dhe rrethanat personale se është i moshës së re, pendimin dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale; ndërsa **rrethana rënduese** nuk ka gjetur. Andaj, Gjykata në rastin konkret nga rrethanat e lartcekura, ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e këtij të pandehurit, i cili do ta kuptojë rëndësinë e veprës penale të cilën e ka kryer dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektojë që në të ardhmen mos të shkaktoj veprime të ndaluara- përkatësisht mos të kryej vepër penale, si dhe do të ndikojë tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej një (1) viti, nga dita kur ky aktgjykim merr formën e prerë, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, me të cilin dënim do të arrihet edhe qëllimi i dënimit me kusht sipas nenit 47 të KPRK-së, përkatësisht që të mos zbatohet dënimi për vepra penale kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e mjaftueshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale.

Gjykata, të pandehurit me anë të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim, i'a tërheq vërejtjen seriozisht dhe i bëhet me dije se nëse kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës kohore të verifikimit, dënimi i cili ka qenë i kushtëzuar për një kohë të caktuar, do të ekzekutohet.

Vendimi për dënimin plotësues

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 59 par. 2 nënpar.2.5 dhe nenit 64 par.2 të KPRK-së, të pandehurit i shqiptoi dënimin plotësues, ndalimi i drejtimit të automjetit në periudhën kohore të përcaktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për faktin se i njëjti ka paraqitur rrezik

të lartë tek pjesëmarrësit tjerë në komunikacion me lëndime trupore tek i dëmtuari, siç përshkruhet në përshkrimin faktik të veprës penale të lartcekur në këtë aktgjykim.

Shpenzimet e procedurës

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 452 par. 1 dhe nenit 449 par. 2 të KPP-së, e ngarkoi të akuzuarin me shpenzimet e procedurës të precizuara si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi, e po ashtu konform nenit 36 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, e obligoi të paguaj shumën prej 20 euro në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit.

Udhëzimi i palës së dëmtuar për kërkesat pasurore-juridike

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil, është marr konform nenit 462 par.2 të KPP-së.

Gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara e në bazë të neneve 242, 364 dhe 369 të KPP-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

Procesmbajtësja
Hale Ahmetaj

GJYQTARI
Petrit Nrecaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovë në Prishtinë, *në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.*